



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Agjencia za Vazdušno Navigacijske Usluge  
Air Navigation Services Agency

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA		AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR AGJENCIA ZA VAZDUŠNO NAVIGACIJSKE USLUGE AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E ARKIVES KANÇELARIJA ARHIVA ARCHIVES OFFICE			
Nr. fsg. Br. str. Pg. no.	19	Data Date	26.02.2020
Nr. prot. Br. prot. Prot. no.	0117	F.H	LIPJAN, RKS

# Statuti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)



**Versioni 3.0**

**Nr. Ref: ASHNA-NJAB-STA**

**Data e Ver.: 26.02.2020**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge  
Air Navigation Services Agency

## Hyrje

Ky manual është pronë e:

Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
10070 Vrellë, Lipjan  
Republika e Kosovës

Prona intelektuale e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) mbrohet në bazë të Ligjit Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Çdo kopjim ose riprodhim i këtij materiali pa lejen me shkrim të publikuesit është i ndaluar.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë procesit të rregulluar të shpërndarjes ose trajnimeve të brendshme të ASHNA-s do të konsiderohet si shkelje e procedurave të ASHNA-s dhe në kundërshtim me ligjin.

Bahri Nuredini  
Drejtor



Njësia Organizative: NJAB  
Nr. Ref. /Kodi: ASHNA-NJAB-  
Ver.: 3.0  
Data e Ver.: 26.02.2020

Faqe 2 nga 19



**Lista e faqeve efektive**

Kapitulli	Faqet	Nr. i revidimit	Data e hyrjes në fuqi
Hyrje	2/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Lista e faqeve efektive	3/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Aprovimi / Regjistrimi i ndryshimeve / Lista e shpërndarjes	4/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Shkurtesat	5/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Përmbajtja	6/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Përkufizimet	8/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	9/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme	10/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli II Kompetencat dhe llogaridhënia e Njesisë së Auditimit të Brendshëm	10/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	11/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	12/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli III Pavarësia	12/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	13/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli IV Përgjegjësia	13/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli V Autoriteti	14/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	15/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli VI Komunikimi dhe format e raportimit	15/18	Versioni 3.0	26.02.2020
	16/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	17/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	18/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli VII Kohëzgjatja e auditimit	18/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli VIII Përgjegjësitë e menaxhmentit të lartë të ASHNA-së për Auditimin e Brendshëm	18/19	Versioni 3.0	26.02.2020
	19/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli IX Mjetet e punës dhe sigurimi i cilësisë	19/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli X Zotësia dhe kujdesi i duhur profesional	19/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli XI Marrëdhëniet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm me Auditorin e Jashtëm	19/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli XII Marrëdhëniet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm me Komitetin e Auditimit	20/19	Versioni 3.0	26.02.2020
Kapitulli XIII Dispozitat përfundimtare	21/19	Versioni 3.0	26.02.2020





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

### Aprovimi

	Emri / Pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Xhyldane Kiçmari, Drejtor i NJAB - së	26.02 2020	<i>Ilir Rexhi</i>
Kontrolli i Cilësisë nga:	Armend Mustafa, Menaxher i Departamentit për Cilësi, Siguri dhe Sigurim	26.02 2020	<i>Armend Mustafa</i>
Aprovuar nga:	Ruhan Kadriu, Kryesues i Komitetit të Auditimit në ASHNA	26/02/20	<i>Ruhan Kadriu</i>
Aprovuar nga:	Bahri Nuredini, Drejtori i ASHNA	26.02.2020	<i>Bahri Nuredini</i>

### Regjistrimi i ndryshimeve

Versioni - Revidimi	Data e revidimit	Faqet e afektuara	Vërejtje
Original (Versioni 3.0)	26.02.2020	Të gjitha	

### Lista e shpërndarjes

Kopja	Vendndodhja	Forma	Copë
1	NJAB	E shtypur	1
2	Sistemi për Menaxhimin e Dokumentacionit (DMS) i ASHNA-s	Elektronike	1
3	Arkivi i ASHNA	E shtypur	1
4	NJQHAB	Elektronike dhe e shtypur	1



Njësia Organizative: NJAB  
Nr. Ref. /Kodi: ASHNA-NJAB-  
Ver.: 3.0  
Data e Ver.: 26.02.2020

Faqe 4 nga 19



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge  
Air Navigation Services Agency

## Shkurtesat

Shkurtesa	Kuptimi
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
NJQHAB	Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
LKBFP	Ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike
Standardet	Standardet Ndërkombetare për Praktiken Profesionale të Auditoreve të Brendshëm
AB	Auditor i Brendshëm
SSP	Subjekt i Sektorit Publik
IAB	Instituti për Auditim të Brendshëm



Njësia Organizative: NJAB  
Nr. Ref. /Kodi: ASHNA-NJAB-  
Ver.: 3.0  
Data e Ver.: 26.02.2020

Faqe 5 nga 19



## Përmbajtja

Hyrje .....	2
Lista e faqeve efektive.....	3
Aprovimi .....	4
Regjistrimi i ndryshimeve .....	4
Lista e shpërndarjes.....	4
Shkurtesat .....	5
Përmbajtja .....	6
Përkufizimet .....	9
Kapitulli I.....	11
Dispozitat e përgjithshme .....	11
Qëllimi i Statutit .....	11
Qëllimi dhe misioni i auditimit të brendshëm.....	11
Pavarësia dhe statusi organizativ .....	11
Kapitulli II.....	12
Vendosja, organizimi dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.....	12
Ndryshimi i kompetencave .....	12
Funksioni i auditimit të brendshëm .....	12
Parimet e funksionit të auditimit të brendshëm.....	12
Përgjegjësia e Drejtorit të ASHNA-së për funksionin e auditimit të brendshëm.....	13
Të drejtat e Drejtorit të NJAB-së dhe auditorëve të brendshëm.....	13
Obligimet e Drejtorit të NJAB-së dhe auditorëve të brendshëm.....	13
Kapitulli III.....	15
Plani strategjik, vjetor dhe raportet e Njësive të auditimit të brendshëm .....	15
Kapitulli IV .....	15
Komunikimi dhe format e raportimit .....	15
Ekzekutimi i Auditimit .....	16
Dokumentimi i auditimit .....	16
Raporti i auditimit .....	16
Draft raporti i auditimit .....	16
Raporti final i auditimit.....	17
Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit.....	17





---

Raportet për angazhime të veçanta.....	18
Kapitulli V .....	18
Kohëzgjatja e auditimit.....	18
Kapitulli VI .....	18
Marrëdhëniet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm me Auditorin e Jashtëm .....	18
Kapitulli VII .....	19
Roli i Komitetit të Auditimit dhe marrëdhëniet e tij me Njësinë e Auditimit të Brendshëm.....	19
Komunikimi .....	19
Kapitulli VIII .....	19
Dispozitat përfundimtare .....	19
Hyrja në fuqi .....	19





Bazuar në nenet 7 dhe 9 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe pikën 2 të nenit 9 të Rregullores QRK – Nr 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funksonit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik si dhe pikën 3.1.2 të Doracakut të Auditimit të Brendshëm, Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, aprovon:

## Statutin e Njësise së Auditorit të Brendshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror

### Hyrje

“Auditimi i brendshëm” (AB) është aktivitet i pavarur, për të ofruar siguri objektive dhe këshillues, i dizajnuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e organizatës. AB i ndihmon organizatës në përmbushjen e objektivave të saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Funksioni i auditimit është i bazuar në konceptin që menaxheret dhe palët e audituara ta konsiderojnë auditorin e brendshëm si një partner i cili do t’iu ndihmojë në zvogëlimin e rreziqeve me të cilat përballen dhe i cili do të ofrojë njohuri se si organizata do të mund funksiononte në mënyrë më efektive, efektive dhe ekonomike. Partneriteti nënkupton bashkëpunimin e ngushtë me menaxhmentin në secilën fazë të aktivitetit të auditimit.

Për të fituar kredibilitetin e duhur profesional, auditorët duhet të sillen në mënyrë të tillë, që nënkupton së ata duhet që:

- Të bashkëpunojnë me menaxhmentin, në të gjitha nivelet e ASHNA-së;
- Të vlerësojnë në mënyrë objektive efektivitetin dhe efikasitetin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm të ASHNA-së;
- Të vlerësojnë pajtueshmërinë e proceseve të ASHNA-së me terësinë e rregullave të aplikueshme;
- Të ofrojnë raporte të auditimit që i ndihmojnë menaxhmentit për të kuptuar rreziqet e tyre, si dhe të ofrojnë rekomandime për përmirësimin e kontrolleve, proceseve dhe vendimeve për të adresuar rreziqet me të cilat përballen ASHNA;
- Të koordinojnë punën e tyre me auditoret e jashtëm dhe organet e tjera të kontrollit, dhe
- Të kryejnë shërbime këshillëdhënëse profesionale dhe objektive, atëherë kur kërkohet.







## Përkufizimet

Për qëllime të këtij Statuti, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

**ASHNA** – Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

**Statuti i Auditimit të Brendshëm** - është dokument i shkruar dhe i miratuar nga Drejtori i ASHNA-së dhe Komitetit i Auditimit, në të cilin përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e të dy palëve për funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë të pavarur.

**Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik** - nënkupton individin që mban pozitën më të lartë në hierarki në një subjekt të sektorit publik, përgjegjës për arritjen e objektivave të organizatës.

**Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB)** - do të thotë, Njësinë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, të themeluar sipas nenit 7 të këtij ligji.

**Auditimi i Brendshëm (AB)** - nënkupton aktivitetin këshillëdhënës të pavarur dhe objektiv në ofrimin e sigurisë së arsyeshme, që synon shtimin e vlerës dhe përmirësimin e funksionimit të subjektit të sektorit publik, e që ndihmon subjektin në përmbushjen e objektivave, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

**Auditori i brendshëm (AB)** - nënkupton personin fizik ose juridik të caktuar për ofrimin e vlerësimeve të pavarura dhe objektivave për veprimtaritë financiare dhe operative të subjektit publik, i certifikuar sipas nenit 22 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2. i Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

**Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)** - do të thotë, Njësinë e Auditimit të Brendshëm në një subjekt të sektorit publik e themeluar sipas nenit 19 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

**Subjekt i Sektorit Publik (SSP)** - nënkupton përdoruesit e fondeve të buxhetit të shtetit, fondet e veçanta, agjencitë dhe institucionet tjera të themeluara me ligj, ndërmarrjet publike dhe personat tjerë juridik në pronësi të shtetit ose në të cilat shteti është aksionar. Subjekti i sektorit publik nënkupton subjektin në tërësi, duke përfshirë organin kryesor dhe të gjitha nivelet e organeve vartëse.

**Auditimi i bazuar në sistem** - nënkupton një vlerësim rigoroz të sistemit të kontrollit të brendshëm për të vlerësuar nivelin e funksionimit efektiv të kontrolleve.

**Auditimi i pajtueshmërisë** - nënkupton vlerësimin nëse një organizatë ka kryer aktivitetet e saj në pajtueshmëri me gjithë legjislacionin e aplikueshëm, rregulloret, politikat dhe procedurat administrative.

**Auditimi financiar** - nënkupton auditimin që ofron një mendim lidhur me atë se, a paraqesin pasqyrat financiare, të krijuara nga një organizatë, pamjen e vërtetë dhe të drejtë të aspektit financiar të operacioneve për periudhën raportuese, për asetet dhe detyrimet e organizatës, në fund të periudhës, si dhe a janë ato në pajtueshmëri me standardet raportuese të kontabilitetit dhe standardet financiare të adoptuara.

**Auditimi i TI-së** - nënkupton një ekzaminim të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së kontrolleve të cilat mbrojnë sistemet e aplikimit të TI për të siguruar besueshmërinë, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve të TI dhe mirëmbajtjen e informacioneve në këto sisteme.

**Auditimi i performancës** - nënkupton një auditim i ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit me të cilin subjekti i sektorit publik që auditohet i shfrytëzon burimet e veta në ushtrimin e përgjegjësisë së veta.





Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

**Auditim i bazuar në rrezik** - proces i planifikimit të angazhimeve të ardhshme të auditimit, bazuar në vlerësimin e dokumentuar të rrezikut. Plani i auditimit mbështetet mbi analizen dhe vlerësimin e rrezikut dhe përcakton prioritetet e veprimtarisë së AB-së, në përputhje me objektivat kryesore të ASHNA-së.

**Standardet** - Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditorëve të Brendshëm, pjesë e Kornizës së Praktikave Profesionale Ndërkombëtare të AB-së (IPPF), të publikuara nga Instituti i Auditimit të Brendshëm (IAB).

**Kontrolli i Brendshëm** - nënkupton procesin që kryhet nga menaxhmenti dhe personeli i subjektit, i përcaktuar për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e interesit publik dhe objektivave të subjektit.

**Rrezik** - nënkupton mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte në arritjen e objektivave të ASHNA-së.

**Univers i auditimit** - tërësia e funksioneve dhe proceseve të ASHNA-së që i nënshtrohen auditimit. Secili funksion ose proces është objekt i vlerësimit të dokumentuar të rrezikut dhe i sistemit të kontrollit të brendshëm.

**Doracaku i Auditimit të Brendshëm** - doracaku i AB-së që përshkruan procesin dhe metodologjinë e punës së auditimit i aprovuar nga NJQHAB.

**IAB** - Instituti për Auditim të Brendshëm përgjegjes për shpalljen e përkufizimit, standardeve ndërkombëtare dhe kodit të etikës së auditimit të brendshëm.

**Komiteti i Auditimit** - është organ i pavarur këshillëdhënës për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm.

**Siguri e arsyeshme** - nënkupton nivelin e kënaqshëm të besimit, që kostoja e kontrollit nuk i tejkalon përfitimet e pritura.

**Parregullsi** - nënkupton moszbatimin ose zbatimin e gabuar të legjislacionit, që rrjedh si pasojë e veprimit apo mosveprimit të përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për fondet publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat, shpenzimet, pasuritë apo detyrimet.

**Kontrolli para ndodhjes (ex ante)** - nënkupton kontrollet e bëra me qëllim që të garantohet pajtueshmëria e vendimeve financiare, të kryera në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit, para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, përpara se të ndodhë një transaksion.

**Kontrolli pas ndodhjes (ex post)** - nënkupton kontrollet të vazhdueshme, që ushtrohen pas përfundimit të transaksionit në pajtueshmëri me një plan apo sipas kërkesës.

**Ekonomizimi** - nënkupton zvogëlimin e shpenzimeve për arritjen e objektivave në nivelin e kërkuar të cilësisë.

**Efikasiteti** - nënkupton raportin ndërmjet burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës.

**Efektiviteti** - nënkupton masat në të cilën objektivat e një subjekti, procesi apo aktiviteti realizohen si një marrëdhënie ndërmjet arritjeve të planifikuara dhe aktuale. dhe

**Kodi i etikës** - nënkupton parimet relevante për profesionin dhe ushtrimin e auditimit të brendshëm dhe rregullat e mirësjelljes që përshkruajnë sjelljen e pritur nga një auditor i brendshëm.



Njësia Organizative: NJAB  
Nr. Ref./Kodi: ASHNA-NJAB-  
Ver.: 3.0  
Data e Ver.: 26.02.2020

Faqe 10 nga 19



## Kapitulli I

### Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1

#### Qëllimi i Statutit

Statuti i NJAB-së përcakton misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësitë e funksionit të auditimit të brendshëm në ASHNA, të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Standardet, doracakun e auditimit të brendshëm, Ligjin e ASHNA-së si dhe kodin e etikës, që promovon një kulturë etike në ushtrimin e auditimit të brendshëm. Gjithashtu përcakton pozitën, organizimin, fushëveprimin, metodologjinë, raportimin, të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit të NJAB-së dhe bashkëpunimin me Institucionet e tjera.

#### Neni 2

#### Qëllimi dhe misioni i auditimit të brendshëm

Qëllimi i NJAB-së së ASHNA-së është të ofrojë shërbime të pavarura të sigurisë dhe këshillimit të dizajnuara për të shtuar vlera dhe për të përmirësuar veprimtarinë e ASHNA-së. Misioni i auditimit të brendshëm është rritja dhe mbrojtja e vlerave të organizatës, duke u bazuar në rrezik, siguri objektive, këshilla, dhe drejtim. NJAB-ja ndihmon menaxhmentin e ASHNA-së të arrijë objektivat e tij duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e qeverisjes, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit.

NJAB-ja do të ushtroj funksionin e saj duke iu përmbajtur kërkesave të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Kornizës Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Institutit të Auditorëve të Brendshëm, përfshirë Parimet Themelore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet dhe definicionin e Auditimit të Brendshëm, rregulloret, udhëzimeve, doracakeve dhe dokumenteve tjera të vendosura nga NJQHAB dhe të aprovuara nga Ministri i Financave dhe Transfereve.

#### Neni 3

#### Pavarësia dhe statusi organizativ

- 3.1 Në bazë të nenit 4 pika 1.8 e Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Drejtori i ASHNA-së siguron themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë së tij.
- 3.2 Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt Drejtorit të ASHNA-së dhe e njofton Komitetin e Auditimit.
- 3.3 Drejtori i NJAB-së i raporton Drejtorit të ASHNA-së, ndërsa personeli i tij (auditorët) i raportojnë Drejtorit të NJAB-së.
- 3.4 Në raport me strukturat tjera organizative në ASHNA, NJAB ka pavarësi funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.
- 3.5 Drejtori i NJAB-së, duhet t'i konfirmoj Drejtorit të ASHNA-së dhe Komitetit të Auditimit, të paktën një herë në vit pavarësinë organizative të aktivitetit të AB-së.
- 3.6 Organizimi i NJAB-së përcaktohet në rregullorën për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ASHNA dhe në përshkrimin e detyrave të punës së Drejtorit të NJAB-së dhe personelit të saj.





## Kapitulli II

### Funksioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

#### Neni 4

#### Vendosja, organizimi dhe përgjegjësitë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- 4.1 NJAB vendoset në strukturën organizative si njësi e pavarur nga të gjitha funksionet tjera dhe i raporton drejtpërsëdrejti Drejtorit të ASHNA-së.
- NJAB ka pavarësi funksionale për të planifikuar, kryer dhe raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe nuk kryen detyra të tjera që nuk lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm.
- 4.2 NJAB nuk ndikohet nga personat me autoritet nga brenda ose jashtë subjektit të sektorit publik.
- 4.3 Auditorët e brendshëm gjatë kryerjes së auditimit, respektojnë legjislacionin e përgjithshëm në fuqi, kodin e etikës dhe sjelljes, kërkesat specifike të Ligjit si dhe kërkesat relevante të publikuara nga Njësia Qendrore Harmonizuese në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.
- 4.4 Drejtori i NJAB-së diskuton me Drejtorin e ASHNA-së dhe Komitetin e Auditimit lidhur me planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve, që të lehtësohet ndërmarrja e veprimeve efektive për korrigjim.
- 4.5 Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga Drejtori i ASHNA-së.
- 4.6 Të gjithë auditorët e Njësive të auditimit të brendshëm marrin pjesë në trajnime dhe në zhvillim të vazhdueshëm profesional të nevojshëm për të mirëmbajtur, ruajtur certifikatën profesionale të auditimit të brendshëm ndërsa Drejtori i ASHNA-së siguron buxhet të mjaftueshëm për këtë qëllim.

#### Neni 5

#### Ndryshimi i kompetencave

- 3.1 Çdo ndryshim i Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike lidhur me kompetencat e NJAB duhet të zbatohen menjëherë pas hyrjes në fuqi.

#### Neni 6

#### Funksioni i auditimit të brendshëm

- 6.1 NJAB ofron shërbime të sigurisë të pavarura dhe objektive për Drejtorin e ASHNA-së për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe ofron këshilla për përmirësimin e tij.
- 6.2 Shërbimi i sigurisë është shqyrtim objektiv i dëshmimeve me qëllim të ofrimit të vlerësimit të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit të subjektit të sektorit publik.
- 6.3 Fushëveprimi i shërbimit këshillëdhënës bëhet në pajtim me Drejtorin e ASHNA-së, që përfshinë shërbimet e këshillimit, konsultimit dhe shërbimet e trajnimit, me qëllim që të ndihmojë subjektin e sektorit publik për të arritur objektivat e tij.

#### Neni 7

#### Parimet e funksionit të auditimit të brendshëm

- 7.1 Auditimi i brendshëm në sektorin publik ushtrohet bazuar në standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës, metodologjinë e miratuar nga Ministri i Financave dhe Transfereve dhe në pajtueshmëri me parimet, si në vijim: I
- 7.1.1 igjshmërinë;
- 7.1.2 paanshmërinë dhe integritetin;
- 7.1.3 pavarësinë dhe objektivitetin;
- 7.1.4 profesionalizmin dhe kujdesin e duhur profesional; dhe
- 7.1.5 kompetencën dhe konfidencialitetin.





## Neni 8

### Përgjegjësia e Drejtorit të ASHNA-së për funksionin e auditimit të brendshëm

#### 8.1 Drejtori i ASHNA-së:

- 8.1.1 siguron burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe tjera për të mundësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë efektive
- 8.1.2 miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm dhe i dorëzon në Njësinë Qendrore Harmonizuese, më së largu deri më 31 dhjetor të vitit fiskal;
- 8.1.3 siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit; dhe
- 8.1.4 dorëzon Njësisë Qendrore Harmonizuese raportin vjetor për aktivitetet e auditimit të brendshëm.

## Neni 9

### Të drejtat e Drejtorit të NJAB-së dhe auditorëve të brendshëm

#### 9.1 Drejtori i NJAB-së dhe auditorët e brendshëm kanë të drejtë:

- 9.1.1 në qasje të lirë te menaxhmenti, anëtarët e personelit dhe pasuritë e ASHNA-së, që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimit;
- 9.1.2 në qasje të lirë në të gjitha informatat, përfshirë ato të klasifikuara sipas nivelit të tyre të qasjes së lejuar, qasje në sistemet e teknologjisë informative, të gjitha dokumentet dhe të dhënat në dispozicion, përfshirë edhe ato elektronike, që janë të domosdoshme për kryerjen e auditimit; dhe
- 9.1.3 të kërkojnë nga zyrtarët përgjegjës çfarëdo të dhëna, pasqyra përmbledhëse, opinione, konfirmime, dokumente dhe informata tjera të nevojshme, në lidhje me detyrën e auditimit.
- 9.1.4 Auditorët e brendshëm, pas miratimit nga Drejtori i NJAB-së dhe Drejtori i ASHNA-së, kanë të drejtë të verifikojnë strukturat dhe palët jashtë subjektit të sektorit publik, në rastet kur kjo është e nevojshme për kryerjen e auditimit. Ky lloj verifikimi realizohet pas njoftimit paraprak sipas legjislacionit përkatës dhe në koordinim me menaxhmentin e strukturave dhe palëve ku realizohen verifikimet e tilla.

## Neni 10

### Obligimet e Drejtorit të NJAB-së dhe auditorëve të brendshëm

#### 10.1 Drejtori i NJAB-së dhe auditorët e brendshëm:

- 10.1.1 ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministri i Financave dhe Transfereve;
- 10.1.2 veprojnë në përputhje me kriteret e përcaktuara në kodin e etikës, planin e auditimit dhe rregullat për konfidencialitet për auditimin e brendshëm;
- 10.1.3 zhvillojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, dhe ruajnë certifikimin e tyre profesional duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 22 në të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

10.2 Në rast të dyshimit për mashtrim gjatë auditimit, auditori i brendshëm njofton Drejtorin e NJAB-së, i cili menjëherë njofton Drejtorin e ASHNA-së dhe Komitetin e Auditimit.

10.3 Nëse Drejtori i ASHNA-së nuk ndërmerr veprime të duhura, Drejtori i AB-së duhet t'i njoftoj autoritetet kompetente.

10.4 Drejtori i NJAB-së, përveç përgjegjësive të tij, është përgjegjës për:

- 10.4.1 aktivitetet e përgjithshme të NJAB-së;
- 10.4.2 të vepruar në pajtueshmëri me standardet dhe rregulloret e auditimit të brendshëm si dhe metodologjinë e miratuar nga Ministri i Financave dhe Transfereve;





- 10.4.3 përgatitjen dhe dorëzimin e planit strategjik dhe planit vjetor për rishikim dhe miratim tek Drejtori i ASHNA-së dhe Komiteti i Auditimit;
- 10.4.4 bashkërendimin e ndërveprimit me NJQHAB, Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe me institucionet e auditimit të jashtëm, para dorëzimit të regjistrave apo raporteve palëve të jashtme, Drejtori i NJAB-së merr aprovimin nga Drejtori i ASHNA-së;
- 10.4.5 dërgimin e raporteve gjashtë (6) mujore dhe vjetore të NJQH më së largu deri më pesëmbëdhjetë korrik të vitit, respektivisht deri më pesëmbëdhjetë janar të vitit pasues;
- 10.4.6 themelohen programin e sigurisë dhe cilësisë me anë të së cilit drejtori i njab-ës siguron funksionimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm;
- 10.4.7 mirëmbajtje dhe ruajtje të gjitha dosjet e raporteve të auditimit, shënimeve gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte, dhe të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmentit të organizatës buxhetore, departamenteve dhe njësive tjera organizative, menaxhmentit të lartë dhe komitetit të auditimit.
- 10.5 Drejtori i NJAB-së cakton ekipin e auditimit dhe udhëheqësin e ekipit të auditimit.
- 10.6 Drejtori i NJAB-së duhet ta rishikoj dhe ta nënshkruaj raportin përfundimtar dhe ta dërgoj atë tek udhëheqsi i njësisë së audituar, Drejtori i ASHNA-së dhe Komitetit të Auditimit.
- 10.7 NJAB përkatësisht auditorët e brendshëm gjatë auditimit duhet t'i zhvillojnë të gjitha procedurat e parapara sipas standardeve, udhëzimeve, doracakëve dhe dokumenteve tjera të vendosura nga NJQHAB dhe të aprovuara nga Ministri i Financave.
- 3.1 Drejtori i NJAB-së i raporton Drejtorit të ASHNA-së për të gjitha çështjet që i përkasin kryerjes së një auditimi të veçantë, dhe i propozon Drejtorit të ASHNA-së që të angazhojë një ekspert të fushës, ku nevojiten aftësitë dhe shkathtësitë e veçanta që lidhen me kryerjen e auditimit.

## Neni 11

### Kufizimet në punën e auditorëve të brendshëm

- 11.1 Auditorët e brendshëm në punën e tyre janë të paanshëm, objektiv dhe raportojnë për çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit. Në lidhje me këtë auditorët e brendshëm:
- 11.1.1 nuk përfshihen në realizimin e funksioneve të drejtpërdrejta të;
- 11.1.2 nuk mbajnë poste politike, nuk janë anëtarë aktivë të ndonjë subjekti politik dhe nuk emërohen në pozita drejtuese në strukturat e subjekteve politike; dhe
- 11.1.3 nuk kryejnë angazhime auditimi për dhënie të shërbimeve të sigurisë lidhur me funksionet, veprimtaritë dhe strukturat për të cilat ata kanë dhënë shërbime këshilluese ose në të cilat kanë qenë të punësuar gjatë periudhës së kaluar dy (2) vjeçare.

## Neni 12

### Konflikti i interesit

- 12.1 Në rastet kur ka konflikt të interesit apo dyshohet për mundësinë e ndodhjes së konfliktit të interesit, i paraparë si i tillë me legjislacionin në fuqi, dhe i cili mund të paraqitet si rezultat i auditimit, atëherë auditori i brendshëm detyrohet që të njoftojë me shkrim Drejtorin e NJAB-së apo personin kompetent në institucion. Pas njoftimit për një konflikt të tillë, apo mundësinë e ndodhjes, Drejtori i NJAB-së apo personi kompetent, me qëllim të shmangies së një veprë të tillë cakton auditorin e brendshëm në detyra tjera.
- 12.2 Konflikti i interesit, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin e përgjithshëm, ekziston nëse:





- 12.2.1 auditori i brendshëm ka punuar gjatë dy (2) viteve të fundit për subjektin që do të auditohet dhe për të cilin ka përcaktuar, vendosur dhe hartuar procedurat për sistemet ose proceset që janë subjekt i auditimit brenda vitit të kaluar;
- 12.2.2 në mesin e menaxhementit dhe zyrtarëve të lartë që përfshin auditimi, është personi me të cilin auditori i brendshëm ka pasur marrëdhënie afariste në dy (2) vitet e fundit dhe/apo ka marrëdhënie familjare deri në brezin e dytë të familjes, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi; dhe
- 12.2.3 ka rrethana të tjera që mund të çojnë në konflikt të mundshëm interesi, nëse ato janë të konsideruara si të tilla dhe nëse ato janë shpjeguar me shkrim nga drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm.

## Kapitulli III

### Plani strategjik, vjetor dhe raportet e Njësive të auditimit të brendshëm

#### Neni 13

- 13.1 Drejtori i NJAB-së përgatit planin strategjik dhe vjetor, sipas modelit të dhënë në doracakun për auditim të brendshëm nga Njësia Qendrore Harmonizuese.
- 13.2 Drejtori i ASHNA-së dhe Komiteti i Auditimit, e rishikojnë dhe miratojnë planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm. Pas miratimit të tyre, NJAB-ja e dorëzon atë te Njësia Qendrore Harmonizuese, më së largu deri më tridhjetë e një (31) dhjetor të vitit fiskal.
- 13.3 Pas përfundimit të çdo auditimi, raporti i auditimit i dërgohet Drejtorit të ASHNA-së.
- 13.4 Drejtori i NJAB-së përgatit dhe dorëzon raportin e gjashtëmuajorit të parë dhe të dytë, si dhe raportin vjetor tek Drejtori i ASHNA-së, Komiteti i Auditimit dhe Njësia Qendrore për Harmonizimin më së largu deri me pesëmbëdhjetë (15) korrik të vitit dhe, gjegjësisht deri më pesëmbëdhjetë (15) janar të vitit vijues.

## Kapitulli IV

### Komunikimi dhe format e raportimit

#### Neni 14

- 14.1 Drejtori i NJAB do të përgatisë dhe t'i dorëzojë udhëheqsit të njësisë që do jetë subjekt auditimi një njoftim para fillimit të auditimit.
- 14.2 Subjekti i auditimit mund të zgjerohet në rast nëvoje në fusha të tjera në situatat kur auditori vëren parregullsi gjatë veprimtarisë apo indikacione për keqpërdorim apo përvetësim të mundshëm të pasurisë dhe të drejtave. Subjekti i auditimit mund të zgjerohet edhe në rast se auditori vlerëson se kjo do t'i ndihmoj atij për të arritur që të jep opinion me të plotë dhe të saktë. Për çdo zgjerim të mundshëm të subjektit të auditimit duhet të raportohet të Drejtori i NJAB-së, ndërsa ky i fundit është i detyruar të njoftoj Drejtorin e ASHNA-së dhe Komitetin e Auditimit.
- 14.3 Përpara dhe gjatë auditimit, AB, pa kufizim mund të mbledhe informacione dhe dëshmi të nevojshme qoftë për çështje të planifikimit, ashtu edhe të ekzekutimit të auditimit. Kjo duhet të bëhet përmes komunikimit të vazhdueshëm me shkrim midis NJAB së dhe njësisë së audituar. Njësitë e audituara informacionin e kërkuar e japin në mënyrë të plotë dhe të vërtetë brenda një kohe të arsyeshme, që nuk e pengon procesin e auditimit.
- 14.4 Në rastet kur vërtetohet se ka vonesë të qëllimshme të ofrimit të informatave, NJAB mban të drejtën e njoftimit me shkrim të Drejtorit të ASHNA-së dhe Komitetit të Auditimit për zvarritje të angazhimit në veprimtari audituese.





14.5 Në fillim dhe pas kryerjes së auditimit, AB, duhet të mbaj takime me palën e audituar përmes së cilave do të mundësohet informimi dhe diskutimi i fushëveprimit të auditimit dhe rezultateve të dala gjatë auditimit. Kjo duhet të bëhet me qëllim të evitimit të keqkuptimeve të mundshme nga të dy palët në proces.

### Neni 15 Ekzekutimi i Auditimit

Në ta gjitha angazhimet, për kryerjen e auditimit, udhëheqsitë e njësive nën auditim duhet t'u ofrojnë auditoreve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, qasje në librat e llogarive, dosjeve dhe shënimeve në kompjuter, në kohë dhe rrethana të arsyeshme, por në mënyrë të pakufizuar.

### Neni 16 Dokumentimi i auditimit

Procesi i auditimit dhe rezultatet e nxjerra nga çdo auditim i kryer duhet të dokumentohen me dëshmi të qarta dhe të plota, në mënyrë që puna e auditorit të mund të dëshmohet mbi bazën e gjurmëve të auditimit. Dokumentimi do të formalizohet përmes dokumenteve të auditimit si: programe të auditimit, pyetësorë, lista kontrolluese dhe dokumente të tjera të publikuara nga NJQHAB.

### Neni 17 Raporti i auditimit

- 17.1 Raportet e auditimit duhet të jenë të strukturuar mirë dhe të mund të lexohen qartë. Forma standarde e raportit është e publikuar nga NJQHAB.
- 17.2 Raportet e auditimit në tekstin e tyre, për aq sa është e mundur duhet t'i shmangen përdorimit të emrave të personelit të audituar apo që ndërlidhen me auditimin. Atëherë kur është e nevojshme të përkruhet një çështje që patjetër kërkon ndërlidhjen me personelin atëherë mund të përdoret emri i pozitës së punonjësit përgjegjes.
- 17.3 Të gjeturat e prezantuara në raportin final duhet paraprakisht të jenë të dokumentuara nga auditoret.
- 17.4 Raporti i auditimit të brendshëm nuk është dhe nuk duhet të bëhet publik, përveç në rastet e përcaktuara me ligjet e aplikueshme të cilave u nënshtrohet ASHNA dhe atëherë me autorizim paraprak të Drejtorit të ASHNA-së.

### Neni 18 Draft raporti i auditimit

- 18.1 Draft raporti i auditimit do t'i nënshtrohet procesit të rishikimit të cilësisë nga nivelet përgjegjëse të NJAB-së. Drafti i rishikuar dhe i aprovuar nga Drejtori i NJAB-së i dërgohet për komente udhëheqsit të njësisë së audituar, bashkë me një letër përcjellëse që përfshin afatin kohor për kthimin e komenteve të mundshme me shkrim.
- 18.2 Komentet në draft raportin e NJAB-së duhet të ofrohen brenda një afati kohore prej 10 ditë kalendrike nga data e dërgimit për komente.
- 18.3 NJAB, gjatë periudhës deri në fund të afatit për kthim të komenteve do t'i ofroj mundësi njësisë së audituar për t'i diskutuar pa kufizim të gjitha çështjet e trajtuara në Draft raport, në mënyrë që të evitohet çdo keqkuptim të mundshëm.







## Neni 19 Raporti final i auditimit

- 19.1 Raporti final i auditimit përgatitet brenda 1 jave pas përfundimit të komunikimeve dhe skadimit të afatit për komente. Raporti final i auditimit pas sigurimit të cilësisë do të aprovohet nga Drejtori i NJAB-së.
- 19.2 Finalizimi i Raportit mund të shtyhet në rast se krijohen rrethana të arsyshme dhe reale për këtë dhe me aprovim të Drejtorit i NJAB-së.
- 19.3 Raporti i aprovuar do t'i dorëzohet Drejtorit të ASHNA-se, Zv. Drejtorit të fushës përkatëse të audituar, udhëheqsit tjetër të njësisë së audituar dhe atyre që ndërlidhen me temën e audituar apo me rekomandimet dhe masat e propozuara.
- 19.4 Gjithashtu raporti mund t'i dorëzohet edhe personave që Drejtori i NJAB-së gjykon se nëvojitet të njoftohen me rezultatet e auditimit.
- 19.5 Pas pranimit të Raportit final të auditimit, njësia e audituar, në rastet kur i janë dhënë rekomandime është e obliguar që në afat prej jo më shumë se 2 jave të përgatisë Planin e veprimit dhe të përcaktojë masat për adresimin e rekomandimeve.
- 19.6 Plani i veprimit do t'i dërgohet Drejtorit të ASHNA-se, Zv. Drejtorit të fushës përkatëse të audituar dhe NJAB-së për mbikqyrje të zbatimit të metutjeshëm të rekomandimeve, duke u bërë kështu pjesë e raportit final.

## Neni 20 Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit

- 20.1 Përcjellja mund të kryhet përmes monitorimit apo përmes auditimeve përcjellëse më rigoroze.
- 20.2 Monitorimi do të jetë i përshtatshëm atëherë kur:
- 20.2.1 procesi ose aktiviteti i audituar është i rëndësishë së vogël dhe nuk paraqet një pengesë serioze në arritjen e objektivave kryesore të organizatës;
- 20.2.2 dobësitë, gabimet, mangësitë ose parregullsitë e identifikuar nuk janë të rëndësishme;
- 20.2.3 rekomandimet e dhëna janë të lehta për t'u realizuar;
- 20.2.4 veprimi korrigjues nuk është i komplikuar.
- 20.3 Monitorimi i progresit bëhet përmes:
- 20.3.1 marrjes dhe vlerësimit të përgjigjeve të menaxhmentit për të gjeturat e auditimit brenda periudhës së arsyeshme (të themi dy javë) pasi të jenë komunikuar rezultatet e auditimit;
- 20.3.2 pranimit periodik të të dhënave të reja nga menaxhmenti, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përpjekjeve për të korrigjuar dobësitë e raportuara;
- 20.3.3 marrjes dhe vlerësimit të informacioneve nga njësitë e tjera organizative të cilave u është dhënë përgjegjësia për zbatimin e procedurave korrigjuese; dhe
- 20.3.4 raportimit tek menaxhmenti i lartë në lidhje me gjendjen e përgjigjeve për të gjeturat e auditimit.
- 20.4 Në rastet kur drejtori i NJAB-së gjykon që përgjigjet gojore të menaxhmentit ose ato në të shkruara tregojnë se veprimet që tashmë janë ndërmarrë janë të pamjaftueshme kur krahasohen me rëndësinë relative të të gjeturës. Në raste të tilla, mund të kryhet një auditim përcjellës, si pjesë e angazhimit të ardhshëm të auditimit.
- 20.5 Auditimi për përcjellje aplikohet në cilëndo prej rrethanave në vijim:
- 20.5.1 kur gabimet serioze dhe mangësitë/parregullsitë janë identifikuar në auditimin paraprak;
- 20.5.2 kur ekziston rrezik i lartë që menaxhmenti të dështojë në ndërmarrjen e veprimeve përcjellëse;
- 20.5.3 kur zbatimi i rekomandimeve kërkon përgatitje të rregullave dhe rregulloreve të mëtijshme të brendshme;
- 20.5.4 kur ndryshimi i kërkuar i referohet aktiviteteve të një apo më shumë divizioneve ose departamenteve;
- 20.5.5 kur nëvojiten burime të shumta për të prezantuar ndryshimet në organizatë.
- 20.6 Auditimi përcjellës është i ngjashëm me atë në auditimin tradicional, megjithëse objektivat dhe fushëveprimi janë ngushtuar për t'u përqendruar në mangësitë e shënuara në raportin paraprak.





20.7 Në rast të ngecjeve dhe çështjeve të tjera, Drejtori i NJAB-së i raporton Drejtorit të ASHNA-së dhe Komitetit të Auditimit për arsyet e mundshme, nivelin dhe masat e ndërmarra për zbatim.

## Neni 21

### Raportet për angazhime të veçanta

21.1 Raportet e përpiluara si rezultat i angazhimeve konsultuese apo hetimeve të posaçme audituese për mashtrime të dyshuara, parregullsi apo korrupsion do të jenë shumë konfidenciale dhe më formale sesa raportet tjera, që kërkojnë kujdes të veçantë dhe ndjeshmëri në përfundimin dhe zgjidhjen e tyre.

## Kapitulli V

### Kohëzgjatja e auditimit

#### Neni 22

- 22.1 Drejtori i NJAB-së duhet të përcaktoj numrin e ditëve të punës të nevojshme për auditimin e sistemeve të identifikuara sipas planit strategjik për periudhën tre vjeçare.
- 22.2 Ndarja e kohës së nevojshme për secilin auditim individual për fazat; planifikim të auditimit, puna në terren, raportimi dhe përcjellja bëhet në bazë të klasifikimit të rrezikshmërisë së sistemit që auditohet.

## Kapitulli VI

### Marrëdhëniet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm me Auditorin e Jashtëm

#### Neni 23

- 23.1 Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të jashtme në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret dhe aktet nënligjore të Kosovës.
- 23.2 Drejtori i secilës NJAB është përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve me auditorin e jashtëm (në shumicën e rasteve, auditori i jashtëm është Zyra Kombëtare e Auditimit).
- 23.3 Kordinimi dhe bashkëpunimi, përshkruan marrëdhënien ideale të NJAB-së me auditoret e jashtëm. Kjo marrëdhënie është e nevojshme për shkak të dallimit në objektiva midis tyre. Auditoret e jashtëm janë të përqendruar në Auditimin e Pasqyrave Financiare për të dhënë një Opinion se Pasqyrat Financiare përmbajnë apo jo keq deklarime materiale. Auditimi i brendshëm në punën e vet jep një siguri të arsyeshme se Kontrolli i brendshëm i dizajnuar nga ana e menaxhmentit është duke funksionuar.





## Kapitulli VII

### Roli i Komitetit të Auditimit dhe marrëdhëniet e tij me Njësinë e Auditimit të Brendshëm Neni 24

24.1 Komiteti i Auditimit mbështet NJAB-në për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve, operacionet e të cilëve auditohen dhe për të siguruar që rekomandimet e auditorit janë trajtuar si duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

24.2 Marrëdhëniet e NJAB-së me Komitetin e Auditimit zhvillohen në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Statutit të Komitetit të Auditimit, Statutin e NJAB-së dhe rregulloret, udhëzimet, doracakun dhe dokumentet tjera të miratuara nga Ministri i Financave dhe Transfereve.

### Komunikimi Neni 25

Komunikimi efektiv në mes të Komitetit të Auditimit dhe NJAB-së është me rëndësi vendimtare për këtë marrëdhënie.

Aktivitete kyçe të komunikimit janë:

- Takimet në mes të komitetit dhe Drejtorit të NJAB-së;
- Raportet përmbledhëse periodike të aktiviteteve të auditimit të brendshëm; dhe
- Raporti vjetor për aktivitetet e auditimit.

## Kapitulli VIII

### Dispozitat përfundimtare Neni 26

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të statutit me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dispozitat e ligjit mbizotërojnë.

### Hyrja në fuqi Neni 27

Ky statut hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

